ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

Sipas Nenit 109 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Një ankesë kundër: **POLICIA E KOSOVËS**

Për Aktivitetin e Prokurimit:

Nr i Prokurimit	**214-22-10936-5-1-1**
Nr i brendshëm	**214-22-176-511**

Sa i përket tenderit për ***"NDERTIMI I STACIONIT POLICOR VERI PRISHTINË".***

ANKESË

1. Identifikimi i ankuesit*

N.P.N.SH. EUROING SH.P.K
(Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj)

XËRXË P.N
(Adresa)

RAHOVEC — ***21* 000**

(Vendi) — *(Kodi postar)*

+383 49 234000

(Numri Telefonit) — *(Numri i Faks-it)*

Kujtim Thaqi

(Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj)

info@euroing-rks.com
(Adresa elektronike)

06.06.2023
(Data e parashtrimit të ankesës) — *(Nënshkrimi dhe vula)*

**Ankues do të thotë një palë e interesuar për parashtrim të ankesës.*

2. Identifikimi i avokatit

Parashtruesi i ankesës mund ta parashtroj ankesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse ankesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.

Shëno të dhënat si në vijim:

_____
(Emri i avokatit)

_____
(Adresa e plotë)

_____ _____
(Numri i Telefonit) *(Numri i faks-it)*

_____
(Adresa elektronike)

_____ _____
(Data e parashtrimit të ankesës) *(Nënshkrimi dhe vula)*

3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

[Shëno një përshkrim te shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar " Njoftimi për Kontratë" apo "Njoftimi për konkurs te projektimit" dhe, nëse aplikohet "Njoftimi për dhënie të Kontratës", "Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit" apo "Njoftimi për anulim te aktivitetit te prokurimit", nëse aplikohet, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës]:

Njoftimi për kontratë: 17.10.2022 Data e hapjes së ofertave dt.29.11.2022 Njoftimi mbi vendimin i dt.16.02.2023 kur jemi rekomanduar për kontratë Njoftimi mbi vendimin e AK-së: 24.05.2023 kur është anuluar ky aktivitet i prokurimit Kërkesa për rishqyrtim e dt. 26.05.2023 Vendimi për refuzim të kërkesës për rishqyrtim i dt.01.06.2023

4. Procesi i Hapjes së tenderëve, *nëse aplikohet*

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po ☐ **Jo** ☒

Procesi i hapjes është bërë nëpërmes platformës E-Prokurimi.

5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, *nëse aplikohet*

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ?

Po ☒ **Jo** ☐

6. Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve

A keni bërë kërkese për rishqyrtim pranë AK lidhur me arsyet e eliminimit tuaj?

Po [x] **Jo** [ ]

Bashkangjitur keni kërkesën për rishqyrtim dhe vendimin e AK-së për refuzim të kërkesës për rishqyrtim.

7. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs te Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënien e Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

Neni 1 i LPP-së **Neni 6 i LPP-së** **Neni 7 i LPP-së** **Neni 56 i LPP-së** **Neni 59 i LPP-së** **Neni 60 i LPP-së** **Neni 62 i LPP-së** **Neni 72 i LPP-së** **40 i Rregullores nr.001/2022 Për Prokurim Publik** **43 i Rregullores nr.001/2022 Për Prokurim Publik** **45 i Rregullores nr.001/2022 Për Prokurim Publik**

*** Sipas Nenit 118 të LPP, OSHP-ja do të kthej tarifën tuaj nëse ankesa aprovohet si e bazuar. OSHP-ja mund të kërkoj një gjobë shtesë deri në 5,000 Euro në rastet kur OSHP-ja konstaton që të gjitha apo cilado nga pretendimet e parashtruara në ankesë kane qenë te rrejshme ose mashtruese.*

8. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të ankesës tuaj.

Njoftimi për kontratë në këtë aktivitet të prokurimit është bërë me dt.17.10.2022, ndërsa hapja e ofertave është bërë me dt. 29.11.2022. Sa për rikujtim, gjatë vlerësimit të parë neve me dt.14.02.2023 na është dërguar letra standarde për kërkesë për sqarimin e tenderit ku është kërkuar që të qartësohet shuma totale

e ofertës financiare dhe TVSH, e ku është cekur se edhe pse në ofertën financiare ju e keni cekur se TVSH (është e përfshirë në pozicione).
Ne po atë ditë me dt.14.02.2023 kemi kthyer përgjigje ku e kemi cekur se vlera totale e ofertës për projektin në fjalë së bashku me të gjitha obligimet tatimore duke përfshirë TVSH është si në vijim:
Vlera totale me TVSH :1, 367,396.72 euro
Vlera TVSH-së : 208,585.94 euro
Vlera pa TVSH është: 1,158, 810.78 euro
Dhe kemi sqaruar se këto vlera financiare të cekura nga ne, faktohen dhe dokumentohen edhe me procesverbal të Hapjes së ofertave.
Pas këtyre sqarimeve, me dt.16.02.2023 është nxjerr njoftimi mbi vendimin B58 ku ne jemi rekomanduar për kontratë dhe realisht janë marr parasysh sqarimet tona.

Pas këtij veprimi janë dorëzuar dy kërkesa për rishqyrtim nga OE "Pro&Co Group dhe Astra Plan shpk, ku me dt.03.03.2023 janë aprovuar pjesërisht këto kërkesa dhe është anuluar njoftimi mbi vendimin B58 i dt.16.02.2023 dhe lënda është kthyer në rivlerësim.

Me dt.06.03.2023 AK-ja nxjerr njoftimin mbi vendimin dhe lëndën e kthen në rivlerësim.

Nga dt.06.03.2023 deri me dt.24.05.2023 ne nuk kemi pas asnjë informacion, ndërsa me dt.25.03.2023 kemi pranuar njoftimin mbi vendimin B58 ku është anuluar ky aktivitet i prokurimit me arsyetimin se asnjë ofertues nuk është i përgjegjshëm.

Pra rivlerësimi ka zgjat prej datës 06.03.2023 deri me dt.24.05.2023, rreth 79 ditë, ndërsa vlerësimi i tenderëve sipas nenit 40.3 të Rregullores nr.001/2022 Për Prokurim Publik do të kryhet nga AK brenda periudhës më të shkurtër të mundshme kohore dhe jo më shumë se 30 ditë nga hapja e ofertave. Vetëm në raste të jashtëzakonshme dhe të arsyetuara, në veçanti për kontratat e një natyre komplekse, kjo periudhë mund të zgjatet për një afat shtesë prej 20 ditësh.
Neni 40.3 e përcakton qartë "*Procedura për ekzaminimin, vlerësimin dhe krahasimin e tenderëve, dhe nxjerrja e njoftimit mbi vendimin e AK, do të kryhet nga AK brenda periudhës më të shkurtër të mundshme kohore dhe jo më shumë se 30 ditë nga hapja e ofertave. Vetëm në raste të jashtëzakonshme dhe të arsyetuara, në veçanti për kontratat e një natyre komplekse, kjo periudhë mund të zgjatet për një afat shtesë prej 20 ditësh. Procesi i vlerësimit të tenderit do të fillojë menjëherë pas përfundimit të procesit të hapjes së tenderëve*".
Në këtë rast kemi shkelje të afateve ligjore për vlerësim, e sidomos kur kem parasysh që kjo lëndë është vlerësuar njëherë dhe vlerësimi i parë kishte zgjatur prej datës së hapjes që ishte bërë me dt.29.11.2022 deri me dt.16.02.2023 kur ishte nxjerr njoftimi mbi vendimin B58 e ku ne ishim rekomanduar për kontratë.
Pra edhe gjatë vlerësimit të parë e edhe gjatë rivlerësimit, ekzaminimi, vlerësimi dhe krahasimi i ofertave është stërzgjatur dhe janë tejkaluar afatet e përcaktuara me legjislacionin sekondar për vlerësim të ofertave.

Në njoftimin mbi vendimin B58 të dt.24.03.2023 neve na është dërguar letra standarde për tenderues të eliminuar, e ku si arsye e eliminimit është cekur si në vijim:

Tenderi i juaj është administrativisht i papërgjegjshëm:

ARSYETIM

OE është i papërgjegjshëm pasi:

- **Ne listën e përshkrimit te çmimeve nuk e ka plotësuar sipas kërkesës se AK përkatësisht ka ofruar çmimin e njëjtë sikur totali i përgjithshëm PATVSH dhe totalin me TVSH dhe tek TVSH nuk ka vendos çmime po tekst e qe bie ndesh me nenin 44.3 te rregullores për prokurim publik 01/2023.**

Siç shihet, ne jemi eliminuar nga AK-ja për një çështje që neve na është kërkuar sqarime dhe për të cilën çështje ne kishim dhënë sqarime, e që sqarimet tona ishin marr për bazë në vlerësimin e parë dhe ne ishim shpallur fitues në njoftimin mbi vendimin B58 të dt.16.02.2023.

Pra në këtë rast ekzistojnë kundërthënie ndërmjet njoftimit mbi vendimin e dt.16.02.2023 dhe njoftimit mbi vendimin e dt.24.05.2023, e ku të njëjtat vendime janë të nënshkruara nga i njëjti Zyrtar Përgjegjës i Prokurimit.

Në njoftimin mbi vendimin e datës 16.02.2023 ne shpallemi fitues, kurse në njoftimin mbi vendimin e dt.24.05.2023 ne eliminohemi për një çështje që ishte marr parasysh nga vetë autoriteti kontraktues gjatë vlerësimit fillestar.

Sa i përket arsyes së eliminimit, ju sqarojmë se ne kemi ofertuar me çmim 1,158, 810.78 euro pa TVSH, kurse në total me TVSH kemi ofertuar me çmimin prej:1, 367,396.72 euro. Ky fakt konstatohet dhe vërtetohet nga procesverbali i hapjes së ofertave i dt.29.11.2022

Dëshmia si më poshtë

7.	NPN EUROING SH.P.K. XËRXË 21000 RAHOVEC	29/11/2022	NDERTIMI I STACIONIT POLICOR VERI PRISHTINË	PO	1158810.78	1367396.72	JO

Pikërisht çmimi total me TVSH në vlerë prej: 1,367,396.72 euro është vendosur edhe tek formulari i tenderit.

Dëshmia si më poshtë.

1 NDERTIMI I STACIONIT POLICOR VERI PRISHTINË

3. Çmimi total i tenderit është:

1,367,396.72 EUR

Pra siç shihet edhe në procesverbal të hapjes e edhe tek formulari për dorëzim të tenderit çmimi total me TVSH është identik, vlera e njëjtë prej 1, 367,396.72 euro.
Nga këto dëshmi, kuptohet se formulari i tenderit si pjesë kryesore e dosjes së tenderit është i plotësuar si duhet dhe çmimi total me TVSH përputhet 100% me çmimin total me TVSH në procesverbal të hapjes së ofertave.
Sa i përket çështjes së TVSH-së, nga të gjithë dihet se TVSH në Kosovë është 18 % dhe nëse çmimit pa TVSH të dhënë në procesverbal të hapjes i shtohet edhe TVSH-ja atëherë çmimi total me TVSH është 1, 367,396.72 euro, dhe ky çmim është i njëjtë si tek procesverbali i hapjes edhe tek formulari i tenderit. Nëse do të kishte gabime në TVSH atëherë gabimet në lidhje me TVSH lejohen të përmirësohen dhe nuk llogariten gabime aritmetike, prandaj në këtë rast nuk ka asnjë lëshim nga ana e kompanisë tonë.
Këtë e parasheh edhe opinioni i KRPP-së tek pyetja **Nr.2** ku ceket si në vijim:
2. 22.11.2022 Si të veprohet në rastet kur një Operator Ekonomik normën e TVSH-ës të përcaktuar me ligjin mbi TVSH-ën, për një apo më shumë artikuj në ofertën e tij e vendos gabimisht pra e vendos jo në bazë të normës së përcaktuar me Ligjin mbi TVSH-ën?

Konform nenit 87, paragrafit 2, nën-paragrafit 2.2 të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068, dhe Ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në pyetjen e parashtruar, KRPP ofron OPINIONIN, si në vijim:

Në rast se një Operator Ekonomik ofron një çmim ku % (përqindja) e TVSH-ës është e gabuar *(më e lartë apo më e ultë se norma e aplikueshme e TVSH-ës)* Autoriteti Kontraktues do ta korrigjoj % (përqindjen) e atij apo atyre artikujve në bazë të normës së aplikueshme të TVSH-ës pa pasur nevojë të kërkoj sqarime shtesë nga Operatori Ekonomik në fjalë

Sa i përket arsyes së cekur, se ne nuk e kemi plotësuar sipas kërkesës Listën e përshkrimit të çmimeve, ju sqarojmë se është i pabazuar dhe i paqëndrueshëm ky konstatim i AK-së sepse ne qartësuam më lartë se çmimi total me TVSH i dhënë nga ne është 1, 367,396.72 euro, ndërsa se ky çmim është shënuar tek paramasa dhe parallogaria tek rubrika Total pa TVSH dhe i njëjti çmim është dhënë edhe tek rubrika Total me TVSH është lëshim teknik i cili nuk mund të shkaktojë ndryshime materiale ose devijime nga karakteristikat, kushtet, dhe kërkesat e tjera të parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit sepse nuk e ndryshon çmimin final të tenderit. Devijimet e vogla si në këtë rast parashihen edhe në nenin 59.4 pika (ii) të LPP-së.
Se nuk mund të shkaktojë ndryshime materiale ky fakt, dëshmohet me faktin se çmimi pa TVSH është i qartë tek procesverbali i hapjes së ofertave e që është në vlerën prej: 1,158, 810.78 euro, kurse çmim me TVSH dëshmohet po ashtu qartë tek procesverbali i hapjes dhe tek formulari për dorëzim të tenderit që është 1, 367,396.72 euro. Gjithashtu çmimi **total** tek lista e çmimeve përputhet plotësisht me çmimin tek formulari i tenderit dhe tek procesverbali i hapjes ku çmimi me TVSH është 1, 367,396.72 euro.
Pra kemi përputhje të saktë dhe të plotë të çmimit final në **procesverbal të hapjes së ofertave**, tek **formulari i tenderit** dhe **tek lista e përshkrimit të çmimeve**.

Dëshmia e listës së çmimeve

REKAPITULIM PARAMASA DHE PARALLOGARIA E PUNËVE NDËRTIMORE		
Nr.	PËRSHKRIMI I PUNËVE	Shuma Totale (€)
A	ARKITEKTURA	1,091,001.87
B	INSTALIMET ELEKTRIKE	93,362.25
C	INSTALIMET HIDROTEKNIKE	34,014.00
D	INSTALIMET E MAKINERISË	149,018.60
	TOTAL PA TVSH:	1,367,396.72
	TVSH (18%)	E llogaritur ne pos.
	TOTAL ME TVSH:	1,367,396.72

Ne e cekëm edhe më lartë se në këtë rast kemi të bëjmë me një devijim të vogël, ndërsa neni 45.19 i Rregullores Nr.001/2022 për Prokurim Publik e përcakton qartë si në vijim:
"**45.19 Neni 59.4 i LPP-së gjithashtu lejon autoritetin kontraktues që të pranojë ofertat, në raste të gabimeve ose paqartësive dhe në raste të devijimeve të vogla. Në të dyja rastet është një kusht që aspektet materiale të njoftimit për kontratë / dosjen e tenderit nuk janë prekur**".
Ndërsa neni 45.20 i Rregullores Nr.001/2022 për Prokurim Publik e sqaron se çfarë janë aspektet materiale, ku ndër të tjera ceket si në vijim:
"**Mundësia për pranimin e tenderëve, varet nga ajo se çfarë janë "aspektet materiale". Për sa i përket elementeve kontraktuale të dosjes së tenderit, çdo aspekt do të konsiderohet si material, nëse ka mundësi të ndryshojë kushtet e kontratës në lidhje me për shembull cilësinë ose kërkesat e përformancës, çmimin ose mënyrën e pagesës, garancinë, sigurimin ose detyrimin dhe sidomos në rastet kur ndryshimi çon në një reduktim të të drejtave kontraktuale të autoritetit kontraktues ose obligimeve të tenderuesit kontraktual**".
Pra ndryshim në aspektin material konsiderohet nëse ndryshohen kushtet e kontratës në lidhje me cilësinë, performancën, çmimin apo mënyrën e pagesës etj, prandaj në këtë rast kur kem parasysh listën e çmimeve të ofruar nga ne rezulton se nuk ka ndryshim në aspektin material, as në cilësi e as në performancë e as në mënyrë të pagesës sepse çmimi total me TVSH është i qartë dhe me këtë çmim duhet të nënshkruhet kontrata dhe nuk ka asnjë interferim dhe as ndonjë dilemë në kontratën eventuale që do të nënshkruhet.

Në këtë rast aspektet materiale nuk janë prekur ashtu siç ceket në këtë nen.

Sa i përket arsyetimit të AK-së, se ne tek TVSH nuk kemi vendos çmim por tekst dhe kinse ky fakt bie ndesh me nenin 44.3 të Rregullores për prokurim publik Nr.001/2023, ju sqarojmë se është i pabazuar ky konstatim, sepse tek Rubrika TVSH 18%, ne vetëm kemi sqaruar se TVSH është e llogaritur nëpër pozicione. Këtë sqarim ne e kemi bërë edhe kur e kemi dhënë përgjigjen me rastin e kërkesës për sqarime gjatë vlerësimit fillestar, e ku AK-ja e kishte marr parasysh sqarimin.
Sqarimi i dhënë nga ne, nuk është në kundërshtim me asnjë dispozitë ligjore përkundrazi sqarimi e ka bërë të qartë se TVSH-ja është e llogaritur nëpër pozicione, prandaj sqarimi në këtë rast ka ndikim dhe rol pozitiv për të qartësuar llogaritjen e TVSH-së nëpër pozicione dhe nuk bie në kundërshtim me asnjë dispozitë ligjore.
Konstatimi i AK-së se veprimi jonë në këtë rast bie ndesh me nenin 44.3 të Rregullores Nr.001/2022 për Prokurim Publik është plotësisht i pabazuar dhe i paqëndrueshëm sepse kjo dispozitë nuk ka të bëjë fare me këtë rast dhe në këtë nen askund nuk përmend TVSH-ja.

Për më tepër ky nen qartëson qëllimin e dokumenteve standarde që të ndihmohen operatorët ekonomik gjatë përgatitjes së ofertave.
Referimi në këtë nen është plotësisht i pabazë dhe i pasaktë sepse ky nen nuk ka të bëjë fare me vendosje ose jo të çmimit e as me çështje të TVSH-së, por ky nen është interpretuar gabimisht nga AK-ja, sepse po aty shkruan si në vijim:
"44.3 Qëllimi i dokumenteve standarde është që të ndihmohen Operatorët ekonomik gjatë përgatitjes së ofertave. Deklaratat duhet të përmbajnë kërkesat minimale të përcaktuara në formularët standard pa ndryshime në përmbajtje, pa prezantimin e kufizimeve apo kushteve shtesë, ose pa fshirjen e ndonjë kushti të përcaktuar nga autoriteti kontraktues në format standarde. Por kompania që bën deklaratën ka të drejtë që të vendos logon, emrin e kompanisë apo grafikë në krye të faqes „header" apo kudo tjetër në dokumentet standarde".

Kjo dispozitë qartëson se deklaratat duhet ti përmbajnë kërkesat minimale të përcaktuara në formularët standard, pa ndryshime në përmbajtje, pa prezantimin e kufizimeve apo kushteve shtesë, ose pa fshirjen e ndonjë kushti të përcaktuar nga autoriteti kontraktues në format standarde.
Sa për sqarim, lista e çmimeve në këtë rast nuk është formularë standard, prandaj nuk mund të ndërlidheni në këtë rast për formular standard por sidoqoftë edhe po të ishte formulari standard ne nenin 44.3 të Rregullores Nr.001/2022 për Prokurim Publik ceket qartë që deklaratat duhet mos me pas ndryshime në përmbajtje ose fshirjen e ndonjë kushti etj, ndërsa në këtë rast lista e çmimeve e ofruar nga ne nuk ka asnjë ndryshim në përmbajtje as ndonjë fshirje e as ndonjë mangësi esenciale.
Më tej në fund të këtij neni, sqarohet se operatorët ekonomik mund të vendosin logon, emrin e kompanisë apo grafikë në krye të faqes "header" apo kudo tjetër në dokumentet standarde.

Pra ky nen është vetëm qartësim i dokumenteve standarde dhe për më tepër edhe po të ishte lista e çmimeve formular standard, neni 44.3 është në favor të kompanisë tonë në këtë rast sepse lista e ofruar nga ne është pa ndryshime në përmbajtje dhe pa ndonjë ndërhyrje dhe pa ndonjë fshirje të ndonjë kushti të përcaktuar nga autoriteti kontraktues.

Nga konstatimi i AK-së, kuptohet që AK-ja ka keqinterpretuar dhe ka bërë devijime nga lista e çmimeve sepse në këtë rast nuk është shënuar tekst në vend të çmimit, sepse në këtë rubrikë nuk ka pas mu vendos çmim sepse çmimet janë dhënë nëpër pozicione për njësi, e që këto çmime mbizotërojnë në krahasim me çmimin total.

Në atë rubrikë të TVSH, ne vetëm e kemi shënuar se TVSH është e llogaritur në pozicione dhe ky është vetëm sqarim i mirëfilltë.
Në mungesë të bazës ligjore për të na eliminuar, AK-ja i janë referuar nenit 44.3 të Rregullores Nr.001/2022 për Prokurim Publik e ku titulli i këtij neni është **Formularët Standard.**

Pra, çka është me rëndësi është se nuk ndryshon çmimi përfundimtar, ndërsa raste praktike kur nuk është ndryshuar çmimi përfundimtar kemi edhe vendime nga paneli shqyrtues i OSHP-së. P.**sh Vendimi nr.629/20 i dt.09.10.2020.**

Po ashtu së fundmi e kemi edhe një ekspertizë të ekspertit shqyrtues të OSHP-së, ku ne jemi fitues, ndërsa ankuesi është ankuar për çështje të njëjtë si në këtë rast që na keni eliminuar, ndërsa eksperti shqyrtues në ekspertizën **Nr. 2023/0158 të dt.06.04.2023** ka konstatuar se fakti i njëjtë është devijim i vogël që nuk ndikon në substancë, në përmbajtje dhe nuk përbën ndryshim material. **Po ashtu edhe vendimi i panelit shqyrtues nr.2023/0158 i dt.30.05.2023 e ka konstatuar një gjë të tillë.**
Rasti ka të bëjë me tenderin "Ndërtimi i objektit te salles se Edukates Fizike dhe ngrohtores se SHFMU Abdyl Frasheri -Prizren" me nr. të prokurimit: "208 Udheheqesi-22-4207-5-2-1", iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – MINISTRIA E ARSIMIT.

Ne pajtohemi me arsyet e eliminimit të OE **ALBER SHPK** se i njëjti nuk ka vazhduar validitetin dhe sigurimin e tenderit.
I njëjti OE ishte shpallur i papërgjegjshëm edhe në njoftimin mbi vendimin e dt.22.02.2023, prandaj pajtohem edhe me ato arsye të eliminimit që ishin dhënë atëherë dhe konsiderojmë se është i papërgjegjshëm për arsyet si në vijim:

Tenderi i juaj është administrativisht i papërgjegjshëm:
ARSYETIM
OE është i pa përgjegjshëm pasi nuk i ka plotësuar specifikat teknike sipas dosjes së tenderit dhe ju mungojnë këto dëshmi si në vijim:

a) Dy kamiona vetshkarkues 10m3-13m3
b) Dy eskavator me minum 8 ton
c) Çertifikata e punëtorit për dhënien e ndihmës së parë,
ç) Çertifikata për shuarjen e zjarrit (përdorim të pajisjeve për për shuarje të zjarrit).

Gjithashtu pajtohem me arsyet e eliminimit të OE **Hidroprojket SHPk&Engroup Shpk** ku e keni cekur:

ARSYETIM

- **Grupi i OE është i papërgjegjshëm pasi:**
  Në listën e përshkrimit te çmimeve tek pozicioni: 2 KALDATORJA 2.28 keni ofruar çmime për njësi më shumë se dy numra mbas presjes dhjetor përkatësisht me 5 numra mbas presjes dhjetor e cila nuk lejohet Sipas LPP.

Pajtohem gjithashtu edhe me arsyet e eliminimit të operatorëve ekonomik tjerë që janë me çmim më të shtrenjtë se oferta jonë.

Ne me dt.01.06.2023 kemi pranuar vendimin për refuzimin e kërkesës për rishqyrtim, ku AK-ja e ka cekur se e njëjta është e pa bazuar, mirëpo nuk ka ofruar fakte dhe prova konkrete për një refuzim të tillë.

Autoriteti kontraktues në vendimin për refuzim në lidhje me pretendimin tonë sa i përket arsyes se eliminimit ka dhënë përgjigjen si në vijim "Pretendimi 1 OE nuk ka dhënë fakte apo argumente ne veçanti pse janë shkelur nene e supozuara mirëpo ka dhënë disa pretendime qe do ju përgjigjemi ne vijim: ne lidhje me sqarimin e kërkuar ka qen për herën e pare ku lënda është kthyer ne ri-vlerësim ndërsa gjate ri-vlerësimit nuk kemi kërkuar asnjë sqarime nga OE ankues, për faktin se OE është konsideruar i papërgjegjshëm duke u bazuar ne nenin 44.3 te rregullores për prokurim publik OE nuk ka te drejt te ndryshoje formularin

e tenderit dhe as listën e përshkrimit te çmimeve ne rastin konkret OE nuk e ka plotësuar listën e përshkrimit te çmimeve sipas kërkesës se AK, pasi OE ne listën e përshkrimit te çmimeve ka shkruar te njëjtin total sikur te totali me TVSH dhe sikur Totali pa TVSH ndërsa TVSH nuk e ka shkruar fare dhe mbi ketë baze OE është shpallur i papërgjegjshëm".

Arsyetimi i lartcekur i AK-së është i paqëndrueshëm për faktin se ne nuk e kemi cekur që gjatë rivlerësimit na janë kërkuar sqarime shtesë, mirëpo e kemi specifikuar saktë se gjatë vlerësimit të parë na janë kërkuar sqarime shtesë dhe pasi që i kemi dhënë sqarimet AK-ja e kishte publikuar njoftimin mbi vendimin e saj dhe na kishte rekomanduar për kontratë, pra e njëjta i kishte marr parasysh sqarimet e dhëna nga ne.

Në vazhdim AK-ja i është referuar nenit 44.3 të Rregullores për Prokurim Publik, me arsyetimin se OE nuk ka të drejtë të ndryshoj formularin e tenderit dhe as listën e përshkrimit të çmimeve. Ky arsyetim i AK-së është i pa bazuar, pasi që ne nuk kemi ndryshuar formularin e tenderit dhe as listën e çmimeve siç ka pretenduar AK-ja. Ne e kemi sqaruar qartë në kërkesë për rishqyrtim e edhe tani në ankesë se ne kemi ofertuar me çmim 1,158, 810.78 euro pa TVSH, kurse në total me TVSH kemi ofertuar me çmimin prej:1, 367,396.72 euro.
Ky fakt konstatohet dhe vërtetohet nga procesverbali i hapjes së ofertave i dt.29.11.202, formulari i tenderit dhe lista e çmimeve.

Nga këto dëshmi, kuptohet se formulari i tenderit si pjesë kryesore e dosjes së tenderit është plotësuar si duhet dhe çmimi total me TVSH përputhet 100% me çmimin total me TVSH në procesverbal të hapjes së ofertave dhe si përfundim konstatimi i lartcekur i AK-së është i paqëndrueshëm. Në këtë rast AK-ja i është referuar plotësisht gabimisht dispozitës së lartcekur sepse ky nen nuk ka të bëjë fare me rastin konkret ashtu siç e kemi elaboruar më lartë në ankesë.

AK-ja në vazhdim të vendimit për refuzim të kërkesës për rishqyrtim ka dhënë sqarimin si në vijim "Pretendimi 2 se ri-vlerësimit ka zgjatur me shumë se sa lejohet me ligie është bërë pikërisht për ti rishikuar në detaje të gjitha ofertat dhe për tu siguruar se a janë në harmoni të plotë me kriteret kualifikuese dhe të bazuara në ligi".

Nga arsyetimi i lartcekur i AK-së konfirmohet edhe nga vetë AK-ja se procesi i rivlerësimit nuk është bërë konform dispozitave ligjore të parapara me ligj edhe sa i përket afateve, pasi që e njëjta i ka tejkaluar të gjitha afatet ligjore për vlerësimin e ofertave. Normalisht vlerësimi i ofertave duhet të bëhet brenda afateve ligjore dhe natyrisht duke analizuar brenda kësaj periudhe se ofertat a janë në harmoni me kriteret dhe kërkesat FDT-së.

Më tutje në vendimin për refuzim të kërkesës për rishqyrtim, AK-ja ka dhënë arsyetimet si në vijim "Pretendimi 3 Arsyeje e eliminimit te OE ankues e dhamë edhe me larte ku i njëjti nuk e ka plotësuar listën e përshkrimit te çmimeve sipas kërkesës se AK duke ber ndryshe e te cilat nuk lejohen sipas interpretimit te KRPP-se te datës 02.03.2023.

Në lidhje me këtë konstatim, sqarojmë se nuk ekziston asnjë interpretim i KRPP-së e as ndonjë dispozitë që rastin konkret e parasheh si shkelje ligjore por AK-ja në mënyrë subjektive ka mundur dhe mund të bëjë interpretime të njëanshme të dispozitave të LPP-së

apo të ndonjë interpretimi të KRPP-së, mirëpo veprimi i AK-së për të na eliminuar neve nuk ka asnjë mbështetje ligjore

Në arsyetimin e tyre, AK-ja ndër të tjera e ka cekur si në vijim "Pretendimi 4 Ne lidhje me at se ne proces verbal te hapjes ju keni ofruar çmimin me TVSH dhe pa TVSH atëherë si është e mundur tek lista e përshkrimit te çmimeve te vendosni te njëjtën vlere sikur me TVSH dhe pa-TVSH ashtu siç e thamë me larte oferta juaj është e papërgjegjshme pasi nuk është plotësuar sipas kërkesës se AK.

Në lidhje me këtë konstatim, ne shumë mirë dhe qartë e kemi cekur, se tek lista e çmimeve TVSH-ja është e llogaritur nëpër pozicione, prandaj në këtë rast nuk ka asnjë dilemë.

Arsyetimi tjetër i AK-së ka qenë si në vijim "Pretendimi 5 Sa i përket pretendimit ankimor ne lidhje me TVSH ju informojë se AK nuk ju ka eliminuar për normën e TVSh por pse nuk e keni plotësuar listën e përshkrimit te çmimeve sipas kërkesës se AK". Edhe ky konstatim është i paqëndrueshëm sepse lista e përshkrimit të çmimeve është plotësuar si duhet ndërsa ne vetëm e kemi sqaruar se tek rastet kur norma e TVSH është vendosur gabimisht mund të korrigjohet dhe e kemi sqaruar se TVSH-ja nuk hyn në gabime aritmetikore por mund të korrigjohet.

Arsyetimet e AK-së se nuk janë shkelur të gjitha dispozitat e LPP-së në këtë tender, janë të paqëndrueshme sepse të gjitha dispozitat e cekura në kërkesë për rishqyrtim janë shkelur për shkak se ne jemi eliminuar pa bazë ligjore, prandaj me këtë rast ka ndodh diskriminim i kompanisë tonë në kundërshtim me nenin 7 të LPP-së.

Kur analizohen arsyetimet e AK-së për refuzimin e kërkesës për rishqyrtim, shihet qartë se AK-ja në asnjë mënyrë nuk ka mundur të vërtetoj të kundërtën e pretendimeve tona ankimore, mirëpo në të gjitha rastet vetëm e cek se nuk është plotësuar lista e çmimeve sipas kërkesës edhe pse një arsyetim i tillë nuk qëndron, ashtu siç e sqaruam edhe më lartë.

Sa i përket pretendimit tonë ku i jemi referuar vendimit të P.SH me nr.629/20 i dt.09.10.2020 dhe ekspertizës së një eksperti shqyrtues përkatësisht ekspertizës me nr. 2023/0158 të dt.06.04.2023, AK-ja nuk i ka marr parasysh fare këto pretendime tona, duke u munduar të devijoj nga pretendimi me pretekstin se këto vendime nuk vlejnë për këtë procedurë dhe se ekspertiza e ekspertit nuk mund të përdoret sepse nuk ka pasur një vendim të panelit shqyrtues. Sa i përket konstatimit të AK-së se nuk ka vendim në lidhje me ekspertizën nr.2023/0158, ju sqarojmë se edhe në lidhje me këtë ekspertizë ekziston vendimi i panelit shqyrtues me nr.2023/0158 i dt.30.05.2023, ku janë konfirmuar konstatimet e ekspertit shqyrtues.

Në lidhje me këtë konstatim, sqarojmë se praktikat e njëjta duhet të aplikohen në raste të njëjta, prandaj nuk mund të anashkalohen as vendimet paraprake të OSHP-së e as ekspertizat sepse në këtë rast OSHP-ja është institucioni kompetent për shqyrtim të ankesave dhe vendimet e tyre janë ekzekutive.

Duke u bazuar në faktet e lartcekura, kuptohet qartë se vendimi i AK-së për refuzimin e kërkesës tonë për rishqyrtim është i pa bazuar dhe i paqëndrueshëm, pa ndonjë mbështetje ligjore mirëpo vetëm janë bërë konstatime të cilat nuk e vërtetojnë për asnjë moment të kundërtën e pretendimeve tona ankimore.

Duke pasur parasysh faktet e lartcekura rezulton se ekzaminimi, vlerësimi dhe krahasimi i tenderëve nuk është bërë në harmoni me nenin 59 të LPP-së, duke u diskriminuar ne si kompani e përgjegjshme dhe me çmim më të ulët.

Anulimi i këtij aktiviteti të prokurimit është bërë në kundërshtim me nenin 62 të LPP-së dhe nenin 44.3 dhe 44.7 i Rregullores nr.001/2022 Për Prokurim Publik, sepse ne jemi ofertues i përgjegjshëm dhe i plotësojmë të gjitha kërkesat e FDT-së dhe të njoftimit për kontratë.

Në këtë aktivitet të prokurimit, nuk është respektuar edhe kriteri kryesor për dhënie të kontratës, e që ka qenë tenderi i përgjegjshëm me çmim më të ulët, konform nenit 60 paragrafi 1.1 i LPP-së.

Gjithashtu AK-ja nuk e ka respektuar edhe nenin 7 të LPP-së, duke na diskriminuar neve si operator ekonomik, edhe pse i kemi plotësuar të gjitha kërkesat e FTD-së dhe të njoftimit për kontratë, nuk jemi shpallur fitues të këtij tenderi, kurse paragrafi 1 i nenit 7 të LPP-së e parasheh qartë që "**Autoriteti kontraktues do ti trajtoj operatorët ekonomik në mënyrë të barabartë dhe jo-diskriminuese dhe do të veprojë në mënyrë transparente**.

Gjithashtu autoriteti kontraktues nuk e ka pasur në konsideratë edhe nenin 1 dhe nenin 6 të LPP-së, pasi që dihet se qëllimi i këtij ligji është të sigurojë mënyrën më efikase, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike, burimeve publike si dhe të gjitha fondeve dhe burimeve të tjera të autoriteteve kontraktuese në Kosovë, ndërsa ju në këtë rast keni vepruar në kundërshtim me këto dispozita dhe duke e rrezikuar dëmtimin e buxhetit pa ndonjë arsye konkrete, duke na eliminuar neve si ofertues i përgjegjshëm dhe me çmim më të ulët.

Duke pasur parasysh të gjitha faktet dhe argumentet që u cekën më lartë, kërkojmë nga OSHP-ja që të merr:

VENDIM

APROVOHET, si e bazuar ankesa e **N.P.N.SH. EUROING SH.P.K**
ANULOHET njoftimi mbi vendimin e AK-së(B58) për anulimin e aktivitetit të prokurimit dhe lënda të kthehet në **RIVLERËSIM, ndërsa rivlerësimi i** ofertave të bëhet sipas dispozitave ligjore të LPP-së dhe konform kërkesave të dosjes së tenderit dhe të njoftimit për kontratë përndryshe ne do të detyrohemi të vazhdojmë me ankesa dhe kundërshtime për këto shkelje në instancat tjera më të larta.

9. Dëmet materiale

Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar i ka shkaktuar ose kërcënohet t'i shkaktojë dëme materiale parashtruesit të ankesës, ne rast se përfshini pretendime për kompensim.

Neve na janë shkaktuar dëme në vlerë rreth 6 mijë euro deri më tani.

10. Lista e dokumenteve (dëshmive) të bashkangjitura

Nëse aplikohet, bashkëngjitni Ankesës dokumentet e renditura më poshtë:

a) *një kopje të publikimit të "Njoftimit për Kontratë" apo "Njoftimit për Konkurs të Projektimit.*
b) *një kopje të publikimit për "Njoftimin e Dhënies së Kontratës" apo "Njoftimin për Rezultatet e Konkursit të Projektimit" apo "Njoftimit për Anulim".*
c) *një kopje të letrës së eliminimit të tenderuesit/kandidatit/ letrës se tenderuesit të pasuksesshëm/ letrës për mos para-kualifikim.*
d) *një kopje të procesverbalit të hapjes publike të tenderëve, nëse aplikohet,*
e) *bashkëngjit një kopje te vendimit te miratuar nga AK gjate kontekstit paraprak te zgjidhjes se mosmarrëveshjeve ne përputhje me nenin 108A te LPP-se,*
f) *Dëshminë e pagesës se tarifës se ankimit ne përputhje me nenin 118 te LPP-se, dhe*
g) *të gjitha korrespondencat e juaja me autoritetin kontraktues duke përfshirë e-mailat si dhe çdo informatë të shkruar që ka të bëjë me këtë aktivitet prokurimi, si dhe me secilin pretendim të paraqitur në ankesë.*

****Sipas Nenit 111.2 të LPP, Parashtruesi i ankesës, origjinalin e ankesës do t'ia dorëzojë OSHP-së dhe njëkohësisht një kopje do t'ia dërgojë në mënyrën më të shpejtë të mundshme Autoritetit Kontraktues.*